

Gjeni më poshtë përgjigjen drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes të Dhënave Personale.

1. Në lidhje me kërkesat tuaja për dokumentacionin e mbajtur nga Bashkia e Tiranës ju sqarojmë se, në pikën 8, të kreut II, të vendimit nr. 352, datë 04.04.2019 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit për vlerësimin dhe negocimin e kontratës, me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese për përzgjedhjen e palës private për realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar, si dhe hartimin e kontratës për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar” është cituar si vijon: *“Çdo dokumentacion i komisionit nënshkruhet nga kryetari dhe vuloset me vulën e Bashkisë së Tiranës dhe protokollohet në protokollin e Bashkisë së Tiranës. Dokumentacioni arkivohet dhe ruhet në arkivin e Bashkisë së Tiranës. Në përfundim të kësaj procedure vlerësimi dhe negocimi, sekretariati i komisionit dorëzon në protokollin e Bashkisë së Tiranës të gjithë dokumentacionin e komisionit. Një kopje e dokumentacionit i dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*. Sqarojmë se kopja e plotë e këtij dokumentacioni do të dorëzohet në arkivat e Bashkisë Tiranës, pas përfundimit të procedurës që po ndiqet nga Komisioni i Vlerësimit dhe Negocimit i cili ndoshet në fazën e negocimit me palën private.

2. Në lidhje me kërkesën tuaj se cilët janë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit dhe Negocimit, ju informojmë se pranë Bashkisë së Tiranës është ngritur Komisioni i Vlerësimit dhe Negocimit, duke respektuar parashikimet ligjore të bëra në Kreun II, pika 1 e vendimit nr. 352, datë 04.04.2019 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit për vlerësimin dhe negocimin e kontratës, me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese për përzgjedhjen e palës private për realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar, si dhe hartimin e kontratës për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar”, ku përcaktohet se: *“Komisioni i vlerësimit dhe negocimit (komisioni) kryesohet nga zëvendëskryetari i Bashkisë së Tiranës dhe përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme: a) Ministria e Kulturës; b) Ministria e Financave dhe Ekonomisë; c) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; ç) Ministria e Drejtësisë; d) Avokatura e Shtetit; dh) Trupa Teatrorë”*.

3. Në lidhje me kërkesën tuaj për shpalljen e fituesit, ju informojmë se nuk ka ende një shoqëri fituese për realizimin e projektit.

Aktualisht Komisioni i Vlerësimit dhe Negocimit ndodhet në fazën e negocimit me shoqërinë “Fusha” shpk, e klasifikuar në vend të parë pas përfundimit të fazës së kualifikimit dhe vlerësimit të zhvilluar nga ky komision sipas parashikimeve të bëra në ligjin me nr. 37/2018 dhe VKM-në nr. 352, datë 04.04.2019.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, ju urojmë punë të mbarë.

Bashkia Tiranë